



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

P.nr.599/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, në lëndën penale, ndaj të pandehurit A. S., nga fsh. V. K. L., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.5633/15 të dt.09.09.2016, për shkak të veprës penale, Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.09.02.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores Farmire Cacaj, dhe të pandehurit, me datë 10.02.2017, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

A. S., i lindur me datën *data e lindjes...*, në L. tani me vendbanim në fsh. nga fsh. V. K. L., me nr. personal *numër personal...* Shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Prej datës së pacaktuar e deri me datën 16.03.2015, i pandehuri në shtëpinë e tij për plotësimin e nevojave të tij, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, ashtu që pa autorizim të K., konsumatori ka keqpërdorë enegjinë elektrike duke u furnizuar m energji elektrike përmes një kablllo ilegale dhe energjia elektrike e shpenzuar fare nuk është regjistruar, me çrast është shkaktuar dëm prej 142.51-€.

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, dhe nenit 320 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së,

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 muajve, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200-€, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse i akuzuari në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale.

DETYROHET i akuzuari që të dëmtuarës K., t'ia kompensojë shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 142.51-€ në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 20 euro, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.5633/15 të dt.09.09.2016, e ka akuzuar të pandehurin A. S., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranim ky i bërë në mënyrë vullnetare, pa presjon dhe konform dispozitave nenit 248 KPRK-së. Poashtu me të gjitha provat dhe faktet tjera që e mbështesin këtë aktakuzë andaj i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe njëherit shton se jam i papunë, mbajtës i vetëm i familjes dhe njëhohësisht kujdesem për një vajzë të motrës e cila është e paralizuar dhe se i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëritet ky veprim, kurse më parë asnjëherë nuk kam rënë ndesh me ligjin, andaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i pandehuri është mbajtës i familjes, sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, dhe sjelljen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për detyrimin e të akuzuarit që t'ia kompensojë dëmin respektivisht kërkesën pasurore- juridike, të dëmtuarës u bazua konform nenit 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 599/16 dt. 10.02.2017

Sekretarja juridike
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.